



Republika e Kosovës

Republika Kosova-Republic of Kosovo

Qeveria –Vlada-Government

Ministria e Arsimit dhe Shkencës/Ministarstvo Obrazovanja i Nauke / Ministry of Education and Science

Thirrje publike për nominim të anëtarëve të Këshillit Shtetëror të Cilësisë në Agjencinë e Kosovës për Akreditim

Ministria e Arsimit dhe Shkencës e Republikës së Kosovës, bazuar në Ligjin për Arsimin e Lartë nr. 04/L-037 dhe Ligjin për Agjencinë e Kosovës për Akreditim nr. 08/L-110, shpall thirrje publike për nominimin e tre (3) anëtarëve vendorë të Këshillit Shtetëror të Cilësisë (KShC) në Agjencinë e Kosovës për Akreditim.

Të drejtë për të nominuar apo vetnominuar për anëtarë të KShC-së kanë të gjithë personat juridikë të regjistruar në Kosovë dhe personat fizikë, shtetas të Republikës së Kosovës.

1. Fushat e nominimit

MASH kërkon nominime për këto fusha:

- Shkencat Mjekësore – një (1) anëtar;
- Shkencat Humane – një (1) anëtar;
- Një (1) anëtar nga radhët e studentëve.

Mandati i anëtarëve të KShC-së është katër (4) vjeçar, me përjashtim të mandatit të anëtarit student, i cili është dy (2) vjeçar.

2. Kriteret për kandidatët

Kandidatët për anëtarë të KShC-së duhet të plotësojnë kriteret në vijim:

- 2.1. Të jenë shtetas të Republikës së Kosovës;
- 2.2. Kandidatët nga stafi akademik duhet të kenë gradën “Doktor i Shkencave”, përvojë hulumtuese të njohur ndërkombëtarisht, përvojë relevante akademike prej së paku pesë (5) vitesh, si dhe përvojë në fushën e sigurimit të cilësisë në arsimin e lartë;
- 2.3. Është e preferueshme njohja e gjuhës angleze;
- 2.4. Në rast se janë diplomuar jashtë Kosovës, të kenë të njohur diplomën nga Qendra

Kombëtare për Njohje, Barasvlerë dhe Informim Akademik (ENIC/NARIC);

2.5. Të kenë njohuri të konsiderueshme për funksionimin e arsimit të lartë dhe të sigurimit të cilësisë në Kosovë, të dëshmuara përmes angazhimeve, pjesëmarrjes në aktivitete, projekte apo pozitive relevante;

2.6. Të kenë njohuri dhe përvojë të konsiderueshme për funksionimin e Zonës Evropiane të Arsimit të Lartë dhe standardeve ndërkombëtare të sigurimit të cilësisë;

2.7. Kandidati nga radhët e studentëve duhet të jetë së paku në nivelin e studimeve master ose doktoratë në IAL-të e Kosovës dhe të ketë njohuri të gjuhës angleze.

E drejta për të nominuar

Çdo person juridik mund të nominojë deri në gjashtë (6) kandidatë për KShC, ndërsa personat fizikë mund të vetnominohen.

Dokumentacioni i nevojshëm për nominim

Dokumentacioni duhet të përmbajë:

1. Formularin e nominimit (aplikimit), të plotësuar dhe të nënshkruar nga kandidati;
2. Bashkëngjitur formularit:
 - a) Në rast nominimi nga institucioni – Deklarata nr. 2;
 - b) Në rast vetnominimi – Deklarata nr. 1;
3. Kopjen e dokumentit identifikues të kandidatit;
4. CV-në e nënshkruar nga kandidati, që dëshmon përmbushjen e kriterëve sipas legjislacionit në fuqi dhe kësaj thirrjeje;
5. Kopjet e noterizuara të diplomave universitare (Bachelor, Master dhe Doktoratë);
6. Për kandidatin student: dëshmi akademike dhe profesionale (kopje të noterizuara të diplomave), si dhe vërtetim zyrtar për statusin aktual si student;
7. Dëshmi për përvojën akademike relevante;
8. Nëse studimet janë përfunduar jashtë vendit: kopjen e vendimit/vendimeve për njohje nga Ministria e Arsimit dhe Shkencës e Republikës së Kosovës;
9. Certifikatën mbi gjendjen penale, të lëshuar nga Këshilli Gjyqësor i Kosovës, që dëshmon se kandidati nuk ka dënime penale në evidencën qendrore (pranohet edhe certifikata online nga platforma e-Kosova).

Vërejtje: Dokumentet e dorëzuara nuk kthehen.

Nuk mund të zgjidhet anëtar i KShC-së personi që:

1. Ka ushtruar funksion politik në Kosovë gjatë tri (3) viteve të fundit;
2. Ka qenë themelues, bashkëthemelues, aksionar apo anëtar i Këshillit Drejtues në një IAL gjatë pesë (5) viteve të fundit;

3. Ka angazhim aktual në më shumë se një institucion të arsimit të lartë, brenda apo jashtë Kosovës;
4. Është dënuar me vendim të formës së prerë për vepër penale të dënueshme me burgim mbi gjashtë (6) muaj, sipas Kodit Penal të Republikës së Kosovës;
5. Gjendet në konflikt interesi, sipas legjislacionit në fuqi.

Informacion me rëndësi për palët:

Kandidatët që përzgjidhen dhe ratifikohen mund të fillojnë ushtrimin e detyrës vetëm pas përfundimit të të gjitha procedurave sipas legjislacionit në fuqi, duke marrë për bazë përfundimin e mandatit të anëtarëve aktualë të KShC-së, sipas afateve të përcaktuara.

Afati për nominime është tetë (8) ditë kalendarike nga dita e shpalljes së thirrjes publike në uebfaqen e MASH-it, përkatësisht deri më 15.04.2026.

Thirrjen dhe formularët e lartpërmendur, të cilët janë pjesë përbërëse e dokumentacionit, mund t'i gjeni në uebfaqen e MASH-it:

<https://mash.rks-gov.net/thirrje/> dhe <https://mash.rks-gov.net/konkurse/>

Dokumentet e kompletuara dorëzohen në zarf të mbyllur, me shënimet përkatëse dhe të nënshkruar, në zyrën nr. 4 (kati përdhes), nga ora 08:00 deri në orën 16:00.

Ministria e Arsimit dhe Shkencës

Rr. "Agim Ramadani", p. n.

10000, Prishtinë, Republika e Kosovës

Për informacione shtesë, nëse është e nevojshme, palët mund të kontaktojnë Departamentin për Arsimin e Lartë në MASH.